



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa nr. 05-350/02-140120/21 dt. 07.06.2021, e pronarit “BP Home Village” llc, njëherit edhe investitor, përmes së cilës kërkohet të caktohen kriteret për ndërtimin e fazës I të kompleksit “Qërshia Village” me 260 shtëpi të banimit individual, të tipit A, B, C me etazhitet P+1 dhe tipi D me etazhitet P+2, në parcelat kadastrale nr. 1354-1 dhe 1884-0 ZK Çagllavicë, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal- PZhK.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 10.06.2021 deri më 24.06.2021, në email adresën: urbanizmi@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	260 shtëpi individuale të banimit
b. Vija rregulluese	Vija e parcelës ndërtimore
c. Vija ndërtimore	3-5m` nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	7.20m` / VN
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	7.20m`
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	26%
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	//
h. Përqindja e sipërfaqes se gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40%
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60%
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	1VP/njësi banesore
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona për rreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ 06/2017 dt. 23.05.2017, për Caktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për Kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve, neni 13, paragrafi 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje njëherësh do të publikohet në ueb faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit:



Faqe 1 prej 1